



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Ilir Konushevci", nr.8 ◆ Prishtinë ◆ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org) [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## NJOFTIM

Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë: 23.07.2014, pas shqyrtimit të Listës së Përkohshme të Ndërmarrjes Shoqërore ("NSH") "Kosovarja-Artizanati" në Prishtinë, ka marrë vendim për anulimin e Listës së Përkohshme të Punëtorëve për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20% nga privatizimi-likuidimi i ndërmarrjes shoqërore "Prizren-Trans" në Prizren.

Lista e Përkohshme e Punëtorëve për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20% nga privatizimi/likuidimi i ndërmarrjes shoqërore "Kosovarja-Artizanati" në Prishtinë, është publikuar me datë 28.02.2014, në mjetet e shkruara të informacionit publik në Kosovë në gazetën Koha Ditore, dhe Kosova Sot, Serbi në gazetën Danas dhe në Mal të Zi në gazetën Vjesti. Në këto shpallje publike është njoftuar për të drejtën e ankese sipas nenit 68.pika 2, 3, dhe 4, e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2003/13 (me ndryshime). Brenda afatit të parapare deri me datë: 24.07.2014, për paraqitjen e ankesave ose kundërshtimeve, kundër listës fillestare është dorëzuar vetëm një(1) ankesë.

Rrjedhimisht, pasi që NSH "Kosovarja-Artizanati" në Prishtinë nuk ka asete të shitura, e në mungesë të fondeve në llogarinë e ndërmarrjes së theksuar më lartë për shpërndarjen e një pjese të të ardhurave prej 20% për punëtorë, Bordi i Drejtorëve të AKP-se sipas rekomandimit të Komisionit për Shqyrtim të Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP) ka vendosur për anulimin e shpalljes së listës së lartcekur të punëtorëve.

Lidhur me vendimin e lartcekur të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, KSHALP do të njoftoj me shkrim individualisht të gjithë personat të cilët kanë paraqitur ankesa/kundërshtime kundër listës fillestare. Paraqitësit e ankesave/kundërshtimeve kundër listës fillestare, nuk janë të obliguar që të paraqesin ankesë/kundërshtim të ri me rastin e rishpalljes së listës fillestare.

Publiku do të njoftohet me shpalljen e listës së re të përkohshme përmes mjeteve të shkruara të informimit publik në Kosovë, në Serbi dhe në Mal të Zi.

Të gjithë të interesuarit për çdo informacion apo paqartësi mund të i drejtohen Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listëve të Punëtorëve.